



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.165 dt.29.09.1997

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e dt.29.09.1997, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Urbanistikës, Drejtorisë së Financës dhe Drejtorisë Juridike, bazuar në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Lokal” kapitulli mbi kompetencat e Këshillit Bashkiak.

VENDOSI

1. Të miratojë rregulloren e paraqitur nga Drejtoria e Urbanistikës, Juridike dhe Financës “Për shitjen e trojeve shtetërore personave fizik e juridik, vendas e të huaj, për rastet kur është ndërtuar mbi të” .
2. Ngarkohen Drejtoritë përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI